

V E N D I M

Nr. _____ Datë ____/____/ 2012

Mbi

Delegimin e dhënies me qera të shesheve mbi 200 m² për një periudhë deri në 1 (një) vit Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv

Këshilli Drejtues në mbledhjen e tij të datës 15.10.2012, pasi mori në shqyrtim propozimin e paraqitur nga Drejtoria Ekzekutive, mbështetur në Ligjin Nr.9130, datë 08.09.2003, "Për Autoritetin Portual", Neni 15; neni 20 pika 1 shkronja a,b,f, pika 3; neni 22; neni 32 pika 1 shkronja a; si dhe VKM Nr.596, datë 10. 09. 2004, "Për Miratimin e Statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për Riorganizimin e tij", Neni 9 pika 6/a; neni 14 pika 1, 2, 6/a Vendimin e Këshillit Drejtues Nr.24 Datë 15.03.2006 "Miratimin e Rregullores së Këshillit Drejtues", Me qëllim rritjen e efikasitetit në administrimin e shesheve të depozitimit në Autoritetin Portual Durrës,

V e n d o s i:

1. Delegimin, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, të së drejtës për të dhënë me qera, sipas procedurës së parashikuar në aktet nënligjore të Këshillit të Ministrave që rregullojnë procedurën e dhënies me qera të pasurisë shtetërore, sipërfaqe (sheshe) mbi 200 m², për një periudhë deri në 1 vit, kompanive të ngarkim/shkarkimit të liçensuara, ose subjekteve të tjera të interesuara për depozitimin dhe/ose kryerjen e aktiviteteve të përpunimit të mallrave, në përputhje me nevojat, veprimtarinë e portit të Durrësit si dhe interesit të shprehur nga vet subjektet.
2. Ngarkohet Drejtoria Ekzekutive e APD-së për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARE
Iva CARA

KRYETARI
Ervin MINAROLLI
Anëtarët
Mirela HASANAJ
Genc MATAJ
Ylli DYLGJERI
Adrian ÇELA
Agim MAKSUTI